



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

V E N D I M

Nr.70. datë 04.05.2016

**PËR SHËRBIMIN E DHËNIES SË INFORMACIONIT DHE SHFRYTËZIMIT TË
DOKUMENTEVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TE KËTIJ SHËRBIMI**

Në mbështetje të nenit 11 të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe të nenit 77 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, Byroja e Kuvendit në mbledhjen e saj të datës 04.05.2016,

V E N D O S I:

1. Kërkesat e personave fizik, juridik, publikë ose privat, për dhënie informacioni dhe/ose vënie në dispozicion të dokumenteve të Kuvendit, plotësohen kundrejt tarifave të përcaktuara.
2. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij.
3. Tarifat për dhënien e informacionit dhe/ose vënies në dispozicion të dokumenteve, janë si më poshtë:
 - a. 1 deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë
 - b. Fotokopje bardhë e zi, / 11 deri në 100 fletë = 9 lek/copa
Format A4 / mbi 100 fletë = 5 lek/copa
 - c. Printime bardhë e zi / 11 deri në 100 fletë = 9 lek /copa
/ mbi 100 fletë = 5 lek/copa
 - ç. Printime me ngjyra / 11 deri në 100 fletë = 20 lek /copa
/ mbi 100 fletë = 10 lek/copa
 - d. Skanime: / 11 deri në 50 skanime = 25 lek /copa
/ 51 deri në 100 skanime = 20 lek/copa

/ mbi 100 skanime = 10 lek/copa

dh. Tarifa e CD-së / 50 lek

4. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.
5. Personat që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, e përfitojnë informacionin dhe/ose dokumentacionin falas, pas vërtetimit të statusit përkatës.
6. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga shërbimi që lëshon informacionin, me mjetet e riprodhimit që disponon Kuvendi.
7. Pagesa e tarifës bëhet në lekë, pranë arkës së Institucionit të Kuvendit kundrejt një mandat pagese dhe më pas Shërbimi i Financës dhe Buxhetit në Kuvend e kalon këtë të ardhur në llogari të buxhetit të shtetit, ose bëhet në bankat e nivelit të dytë, duke tërhequr më parë pranë arkës së Kuvendit dy kopje të faturës së arkëtimit, të miratuar nga Ministria e Financave, ku përfshihet Kodi i Institucionit dhe Kodi i të ardhurave.
8. Materialet e riprodhuara i dorëzohen kërkuarit pas paraqitjes së mandat arkëtimit pranë koordinаторit për të drejtën e informimit.
9. Kërkuari nuk mund të shumfishojë për qëllime shitje informacionin/dhe ose dokumentacionin e marrë sipas këtij Vendimi.
10. Publikimi i tarifave të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi bëhet në faqen zyrtare në internet të Kuvendit të Shqipërisë si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

